

Takimi i 8-të i Komitetit të Stabilizimit dhe Asociimit Shqipëri-BE

Bruksel, 4 tetor 2017



U zhvillua në Bruksel, takimi i 8-të i Komitetit të Stabilizimit dhe Asociimit (SA) mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, i cili u drejtua bashkërisht nga znj. Genoveva Ruiz Calavera, Drejtore për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit në Komisionin Evropian dhe znj. Eralda Cani, Zëvendës Ministre për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.

Të ftuar në këtë takim për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) ishin z. Andi Kananaj, Drejtori Ekzekutiv dhe z. Erion Banushi, Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit.

Komiteti SA vlerësoi zhvillimet më të rëndësishme të vitit të kaluar në fushat e shtetit ligjor, reformës së administratës publike, tregtisë, zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe peshkimit, industrisë, tregut të brendshëm, shoqërisë së informacionit, politikave sociale, transportit, energjisë dhe mjedisit. Gjithashtu u rishikua gjendja në lidhje me zbatimin e asistencës financiare të BE-së.

Komisioni Evropian përshëndeti progresin pozitiv të deritanishëm në të gjitha fushat dhe nënvizoi nevojën për të parë rezultate të prekshme, veçanërisht në reformën e drejtësisë dhe në procesin e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për të vijuar progresin në të gjitha përparësitë kyçe, përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe

krimin të organizuar, përfshirë kultivimin dhe trafikimin e kanabisit, reformën e administratës publike dhe të drejtat themelore.

Përveç pesë përparësive kyçe Komisioni Evropian theksoi se ka edhe çështje të tjera me rëndësi që duhen trajtuar. Në veçanti, Komisioni njohu angazhimin e autoriteteve shqiptare për trajtimin e fenomenit të aplikimeve të pabaza për azil në shtetet anëtare të BE-së dhe i nixti ato të ndjekin një vijimësi të

qëndrueshme përpjekjesh për trajtimin e çështjes. Komisioni Evropian rikujtoi se bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë një pjesë thelbësore e progresit të Shqipërisë në udhën drejt integritit evropian.

U theksua roli i Shqipërisë si partner strategjik i BE-së, si dhe u vu pozitivisht në dukje përafrimi i plotë dhe i vazhdueshëm me politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët të BE-së.

Tryezë e rrumbullakët mbi vetëpunësimin e të rinjve

Tiranë, 11 tetor 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në një tryezë e rrumbullakët, e cila u mbaj në ambjentet e Hotel Tirana International, në kuadër të projektit “Vetëpunësimi i të Rinjve, Pengesat dhe Alternativat: Guida e Vetëpunësimit”, implementuar nga “Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje (IPPM)”. Ky projekt mbështetet nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Në këtë tryezë u paraqit një analizë e detajuar të situatës aktuale e punësimit të të rinjve në Shqipëri, pengesat dhe mundësitë reale që ata kanë si dhe në prezantimin e Manualit të Vetëpunësimit, i cili trajton në një gjuhë të thjeshtë hapat që duhet të ndërmerren për hapjen e një biznesi nga një i ri me ambicie vetëpunësimin.

Paneli i këtij aktiviteti përbëhej nga akademikë dhe ekspertë të shquar si, Prof. Dr. Arben Malaj; Prof. Dr. Adrian Civici; Dr. Kosta Barjaba dhe Dr. Ledjon Shahini, përfaqësues të AMSHC-së, përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi si dhe veçanërisht të rinj të cilët janë në procesin e studimeve të larta dhe të atyre të sapodiplomuar, që janë aktualisht në procesin e kërkimit të një pune.

Në pjesën e fundit të aktivitetit u diskutua ndërmjet pjesëmarrësve dhe ekspertëve mbi mundësinë për ta bërë të aksesueshëm informacionin për të gjithë dhe u shprehën vlerësimet për studimin e bërë nga IPPM si nga ana e të ftuarëve, ashtu edhe nga ana e përfaqësuesve të AMSHC-së.



Trajnim i të rinjve mbi “Ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik”

Shkodër, 26 tetor 2017

Në kuadër të projektit "Rinia Guxon", mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), Shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" organizoi trajnimin mbi "Ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik" për përfaqësues të shoqërisë civile, studentë të Fakultetit Juridik, të sapodiplimuar si dhe përfaqësues të institucioneve publike, ku pati një pjesëmarrje të gjerë.

Në përfundimi të mbylljes së ciklit të trajnimeve u shpërndanë dhe certifikatat e pjesëmarrjes.



Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane dëgjesë mbi vetëpunësimin

Vlorë, 25 tetor 2017

Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane organizon një dëgjesë me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Vlorë mbi statusin e punës dhe të vetëpunësimit në Shqipëri, në kudër të implementimit të projektit “Përmirësimi i politikave për kyçjen e të rinjëve dhe grupeve të marginalizuara në tregun e punës”. Ky projekt mbështetet nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).



Forum i Shoqatave Mjedisore “Festivali Mjedor në Shqipëri dhe kuadri mjedor”

Tiranë, 27 tetor 2017


Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në forumin e shoqatave mjedisore, i cili u mbajt në ambjentet Muzeut Historik Kombëtar, në Tiranë.



Temat kryesore e diskutimit ishin situata e mjedisit; rruga shqiptare drejt integritimit në BE; sfidat kryesore dhe roli i shoqërisë civile në këtë drejtim.

Me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile u diskutua për sfidat e mundësitë ndër vite të filmit dokumentar mjedor në Shqipëri dhe planet për të ardhmen, risitë dhe ide të reja në kuadër të EFA 2018.





Edicioni i Pestë i Festivalit të Filmit Mjedisor – Shqipëri (EFFA 2017)

24 - 28 tetor 2017



Delegacioni i Bashkimit Evropian bashkëfinancon këtë aktivitet në kontekstin më të gjerë të mbështetjes për pranimin e Shqipërisë në BE dhe nevojën për të harmonizuar legjislacionin dhe praktikën e saj me standardet e BE-së; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është pjesë e organizimit të këtij eventi, ndërsa Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane (URI) organizojnë shfaqjen e filmave në sheshet më karakteristike të Tiranës.

Ceremonia e hapjes së EFFA 2017, u mbajt në Tiranë në ambientin piktoresk të Pazarit të Ri, më 24 tetor 2017, në orën 18:00. Fjala përshëndetëse nga znj. Zana Vokopola, Drejtore Ekzekutive (URI); z. Blendi Klosi, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit; z. Mihallaq Qirjo, Drejtor i REC Shqipëri; z. Xhemal Mato, President i Jurisë. Në vijim u shfaq filmi me metrazh të shkurtër “Lake of Apples” dhe në mbyllje u organizua një koktej.

Ditët në vazhdim në bashkëpunim me aktivistë dhe organizata të ndryshme u shfaqën në shumë qyte të vendit filmat e tjerë të përzgjedhur.

Për shpërndarje më mirë të qëllimit të festivalit edhe me komunitetin lokal, gjatë këtyre ditëve, në datat 25, 26 dhe 27 tetor 2017 edhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) transmetoi në mbrëmje për publikun filmat e përzgjedhur, në sheshet “Shtraus”, “Demokracia” dhe “Garibaldi” në qytetin e Tiranës.



25 tetor 2017 – Shfaqja e filmit “La grande monnezza - Life by the land eld”, në sheshin “Shtraus” – Tiranë



26 tetor 2017 – Shfaqja e filmit “Eat, Grow, Love”, në sheshin “Demokracia”, Qyteti Studenti – Tiranë



27 tetor 2017 – Shfaqja e filmit “The tortoise and the tapir”, në sheshin “Garibaldi” – Tiranë

Në mbrëmjen e datës 28 tetor 2017, në ambjentet e Qendrën Multifunkionale “TEN”, u organiza mbyllja e festivalit dhe ndarja e çmimeve për filmat më të mirë:

1. *Filmi më të mirë me metrazh të gjatë: "Sea of Life", nga regjisorja kanadeze Julia Burnes.*
2. *Filmi më të mirë me metrazh të shkurtër: "Lake of Apples", nga regjisorët maqedonas Ljubo Stefanov dhe Tamara Kotevska.*
3. *Filmi më i mirë studentor: "Patok Lagoon - a Paradise to protect" (dokumentar i shkurtër), nga regjisori shqiptar Endrit Zemanaj.*





Më pas për të ftuarit u organizua një koktej me muzikë Live.



Programi Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) nisi sot me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes 12 bashkive

Tiranë, 1 nëntor 2017



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Andi Kananaj merr pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mes 12 bashkive me partner zbatues UNDP Albania, në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) i financuar nga BE.

Rreth 100 organizata të shoqërisë civile do të përfitojnë nga një skemë granti prej 1.2 milionë Euro për Shqipërinë. Projektet e financuara do të ndihmojnë për zbatimin e strategjive vendore

të zhvillimit që përmirësojnë cilësinë e jetës për qytetarët që jetojnë në këto bashki dhe nxisin pjesëmarrjen dhe llogaridhënien.

Ambasadorja e BE-së Romana Vlahutin u shpreh se kjo do të ketë një ndikim të vërtetë mbi jetët e njerëzve, nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku me bashkitë për të siguruar shërbime më të mira, si dhe më të shënjestruara dhe më përfshirëse për qytetarët.



Takim pune i anëtarve të shoqërisë civile të KKSHC-së me përfaqësues nga Kryeministria dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian

Tiranë, 3 nëntor 2017



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Andi Kananaj mori pjesë në takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), përfaqësuesin e Kryeministrisë z. Ergis SEFA dhe përfaqësuesen e Delegacionit të Bashkimit Evropian, znj. Enkelejda Lopari, i cili u mbajt në ambjentet e EU Info Centre – Tiranë.

Qëllimi i takimit ka të bëjë me asistencën teknike nga BE për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, për disa masa në Udhërrëyes përfshirë mbështetje në disa fusha si:

- *Rishikimin afatmesëm të Udhërrëfyesit dhe hartimin e një plani të detajuar me tregues, buxhet dhe kornizë monitorimi për Udhërrëfyesin*
- *Mbështetje e organizatave të Këshillit Kombëtar në punë për t'u organizuar si një platformë si dhe për të punuar rreth prioritetëve sipas fushave*
- *Rekomandime dhe sugjerime për Kornizën ligjore dhe financare për shoqërinë civile*
- *Një vlerësim për mundësinë e një baze të të dhënave për shoqërinë civile*

Kjo asistencë është një mundësi për të mbështetur Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, veçanërisht anëtarët e shoqërisë civile për të hartuar prioritet lidhur me tre fushat përkatëse të veprimit si dhe për t'i paraqitur në mbledhjen e Këshillit.



Eventi përmbyllës i TACSO Albania “8 vjet histori suksesi”

Tiranë, 9 nëntor 2017

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Andi Kananaj mori pjesë në eventin përmbyllës të TACSO Albania – “8 vjet histori suksesi”, i cili u mbajt në ambjettet e Qendrës së Informimit e Bashkimit Evropian – Tiranë.

Në kuadër të këtij event, u organizuan sesione të ndryshme mbi asistencën e TACSO-s dhe mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile si dhe prezantimin e Raportit të Vlerësimit Afatmesëm të IPA/CSF dhe Raportit “Traffic Lights” për Shqipërinë 2017.



Ngrihet "Rrjeti i organizatave të pacientëve me sëmundje kronike"

Tiranë, 14 nëntor 2017



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga shoqata të pacientëve me sëmundje kronike, i cili u mbajt në ambjentet e Hotel "Xheko Imperial".

Të ftuar të tjerë ishin përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale; Fondi i Sigurimeve Shëndetësore; Komiteti Shqiptar i Helsinkit; UNFPA; USAID etj.

Fjalën e hapjes dhe prezantimin e objektivave të punëtorisë e mbajti z. Genci Pasko.

Shtatë shoqata të pacientëve me sëmundje kronike, të cilat përfaqësojnë së paku 300,000 qytetarë u bashkuan dhe ngritën "Rrjetin e organizatave të pacientëve me sëmundje kronike" duke shtuar dhe bashkërenduar përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Ngritja e këtij rrjeti po mbështetet nga projekti "Shëndet për të gjithë" si pjesë e financimeve të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

AMSHC zhvillon takime konsultative me shoqërinë civile

Nëntor 2017

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të shpalljes së Thirrjes së radhës zhvilloi përgjatë muajit Nëntor disa takime konsultative me qëllim marrjen e sugjerimeve mbi përcaktimin e prioritetëve të thirrjes nga organizata të shoqërisë civile.

Takimet konsultative u zhvilluan në qytetet Gjirokastrë, Korçë, Fier, Pukë, Kukës, Bajram Curri, Durrës dhe Shkodër, përkatësisht në datat 2, 8, 10, 15, 17, 22, 27 dhe 30 nëntor 2017.

Pjesëmarrësit vlerësuan iniciativën e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile si një instrument të rëndësishëm i dialogut midis shoqërisë civile dhe institucioneve.

Referuar vlerësimit të gjendjes reale ku ndodhet sektori i shoqërisë pjesëmarrësit dhanë sugjerimet mbi përcaktimin e prioritetëve të thirrjes së radhës, si vijon:

1. Thirrja të jetë e orientuar sipas objektivit të veprimit të OJF-ve ku shihet me interes: integrimi i të rinjve, mbrojtja e mjedisit; edukimi i vet shoqërisë civile;
2. Rritja e kapaciteteve të grupeve, organizatave që kanë si mision të tyre shërbimet sociale, kryesisht dhënie e ndihmes për personat e vetmuar;
3. E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekjen e strategjive për përfshirjen e të rinjve në qeverisje, transparenca buxhetore e institucioneve publike;
4. Fuqizimi strukturave përfaqësuese rinore nëpërmjet hartimit të planit kombëtar;
5. Vënia e theksit për projekte të natyrës së shërbimeve sociale duke ju referuar kartës sociale;
6. Rritja e kujdesit për shtresat vunerabël dhe ato në nevojë;
7. Fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;
8. Nxitja e vullnetarizmit; stimulimi i fuqizimit të këtij aspekti të rëndësishëm të shoqërisë;
9. Më shumë vëmendje ndaj personave me aftësi të kufizuar duke iu mundësuar mjete të domosdoshme për të lehtësuar jetën e tyre;
10. Mbështetje më të madhe për projekte në fushën e të drejtave të njeriut, specifiku të fëmijëve dhe grave të zonave rurale;
11. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit të shoqërisë civile në kuadër të përmirësimit të legjislacionit dhe vënies në zbatim të projekteve të ndryshme;
12. Çështjet mjedisore duke mbrojtur habitatet natyrore, zhvillimin e bujqësisë dhe rrjedhimisht krijimin e një mjedisi për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë;
13. Një formë e rëndësishme në realizimin dhe promovimin e turizmit të lidhur pandashmërisht me mjedisin është trajnimi në lidhje me mbrojtjen dhe njohjen e guidave dhe destinacioneve të reja turistike;
14. Promovimi i llojeve të reja (jo tradicionale) të turizmit në Shqipëri si edhe sporteve ujore dhe tokësore duke pasur parasysh natyrën dhe mjedisin mundësues të vendit tonë;
15. Trajnime për mjeshtëri tradicionale që janë në rrezik zhdukjeje, psh gurgdhëndës, drugdhëndës, mjeshtër restorator të shtëpive karakteristike;
16. Shendetësia, nëpërmjet implementimit të projekteve që ruajnë dhe japin informacione në lidhje me shëndetin fizik dhe mendor, duke u fokusuar tek gratë dhe të rinjtë;
17. Më tepër mbështetje lidhur me çështjet e përfaqësimit të minoriteteve, si (rome, egjiptjan, LGBT, etj)

Gjirokastrë – 02.11.2017



Korçë – 08.11.2017



Fier – 10.11.2017



Pukë – 15.11.2017



Kukës – 17.11.2017



Bajram Curri – 22.11.2017



Durrës – 27.11.2017



Shkodër – 30.11.2017





Rinia shqiptare: “Fund Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave”

Tiranë, 8 dhjetor 2017

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj merr pjesë në aktivitetin “Rinia shqiptare: Fund Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave”, i organizua nga Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim” në kuadër të Ditës Kombëtare së Rinisë, i cili u mbajt në ambjentet e Qendrës Rinore të Tiranës. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin të rinjtë e shkollave të mesme të disa qyteteve të Shqipërisë; përfaqësues nga Ministria e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Ambasada e Suedisë në Tiranë. Gjatë aktivitetit u shfaq dokumentari kundër dhunës dhe trafikimit të vajzave, i përgatitur nga të rinjtë e shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi” si dhe u shpërndanë dhurata dhe çertifikata vlerësimi për disa nga nxënësit pjesëmarrës.

Konsultime publike mbi rishikimin e “Udhërrëfyesit” për politikën e Qeverisë drejt një mjedisi më të përshtatshëm për zhvillimin e shoqërisë civile

Dhjetor 2017



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), Zyra e Kryeministrit dhe ekipi i asistencës teknike të BE-së për promovimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC) organizuan konsultime publike përfaqësues të shoqërisë civile në qytetet: Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë, përkatësisht në datat 4, 6, 11 dhe 13 Dhjetor 2017.

Udhërrëfyeni konsiderohet nga Qeveria e Shqipërisë, ashtu edhe nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, një dokument udhëzues për zhvillimin e shoqërisë civile. Ai reflekton përpjekjet e Qeverisë për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi që lejon shoqërinë civile të realizojë misionin e saj dhe të arrijë ndikim të qëndrueshëm në një mënyrë efektive.

Këto konsultime synojnë të shqyrtojnë përbajtjen dhe fushat prioritare të përcaktuara fillimisht në Udhërrëfyeni, në nëntor 2014. Gjithashtu, mbledhjen e pikëpamjeve dhe propozimeve të shoqërisë civile mbi përmirësimin e dokumentit, implementimin e tij dhe kornizën e monitorimit.

Tiranë – 04.12.2017



Vlorë – 06.12.2017



Shkodër – 11.12.2017



Korçë – 13.12.2017



Partnerët Shqipëri prezantoi Raportin për Shqipërinë 2016-2017 “Monitorimi i të drejtës për tubime paqësore”

Tiranë, 15 dhjetor 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), mori pjesë në një takim i organizuar nga Partnerët Shqipëri, ku u prezantua Raporti për Shqipërinë 2016-2017 “Monitorimi i të drejtës për tubime paqësore”, i cili u mbajt në ambjentet e Hotel Diplomat.

Në praninë e përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse për garantimin e ushtrimit të lirisë për tubime paqësore, si Policia e Shtetit dhe pushteti vendor, si dhe ekspertë nga shoqëria civile, u diskutuan probleme që ndeshen në praktikë sa i përket organizimit të tubimeve, si nga ana e organizatorëve ashtu edhe nga ana e autoriteteve shtetërore.

Në takim u paraqitën edhe rekomandime për iniciativa advokuese që duhet të ndërmerren për të adresuar problematikat në kuadrin ligjor dhe praktikën e ushtrimit të së drejtës për tubime paqësore.

Raporti u hartua nga Partnerët Shqipëri dhe konsiston në analizën e kuadrit ligjor, monitorimin e zbatimit të tij në praktikë, studimin e të dhënave si dhe konsultime me organizata dhe ekspertë në fushën e të drejtës dhe lirisë për tubime paqësore.



Nis konsultimi on-line për “Udhërrëfyesin”

19 dhjetor 2017

Zyra e Kryeministrit dhe ekipi i asistencës teknike të BE-së për promovimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, fton organizatat e shoqërisë civile të japin kontributin e tyre përmes një procesi konsultimi publik online.

Konsultimi online do të jetë i hapur deri me datë 25 Janar 2018, në adresën www.amshc.gov.al

Sugjerimet do të jenë vendimtare jo vetëm për të përmirësuar dokumentin, por edhe për të mbështetur Qeverinë Shqiptare dhe institucionet e saj në zbatimin e veprimeve specifike të lidhura me krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm për ju - aktorët dhe organizatat e shoqërisë civile për t'i shërbyer më mirë të mirës publike.

Konferencë ndërkombëtare - “Standardi EITI”, rrit transparencën dhe nxit investimet e huaja

Tiranë, 20 - 21 dhjetor 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë “Taksat dhe kuadri ligjor i industrive nxjerrëse - rasti i Shqipërisë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare”, e cila u organizua nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), e cila u mbajt në ambjentet e Hotel Rogner.

Në këtë konferencë ndërkombëtare ishin të pranishëm Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Enis Aliko; Drejtori i Sekretariatit Kombëtar Shqiptar të Iniciativës Globale për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse z. Ardit Kamberi; Drejtoresha e Bankës Botërore në Tiranë znj. Maryam Salim; Përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë si dhe Drejtori i Kabinetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë z. Ervin Mete.



Gjithashtu, në këtë konferencë morën pjesë shumë përfaqësues të Partnerëve Ndërkombëtarë, Institucioneve Financiare, Ekspertë Ndërkombëtarë në fushën fiskale dhe legale, përfaqësues të Institucioneve Qendrore, Përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Përfaqësues të Biznesit kryesisht të Industrive Nxjerrëse, përfaqësues të Shoqërisë Civile si dhe anëtarët e MSG të Sekretariatit EITI.

“Standardi EITI”, inkurajon shtetet zbatuese, në zhvillimin e sistemeve ekzistuese të raportimit për mbledhjen e të dhënave, duke i ofruar këto të dhëna si më koherente, të besueshme dhe më të dobishme.

Krahas transparencës, prioritetet është orientimi drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik të vendeve.

Eventi u shoqërua edhe me një Ekspozite Fotografike, në të cilën u evidentuan shumë aspekte dhe pamje nga aktiviteti në sektorët Minerarë, Hidrokarbur dhe Elektro-Energjistik në Shqipëri.



Qendra “Res Publica” prezanton të dhënat kryesore nga studimi rreth efekteve te ligjit “Mbi të Drejtën e Informimit”

Tiranë, 21 dhjetor 2017

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Civil Rights Defenders, Avokati i Popullit, gazetarë, ekspertë dhe shoqëria civile.

Ky aktivitet u organizua nga Qendra “Res Publica” dhe u mbajt në ambjentet Hotel Xheko Imperial.

Aktiviteti u përshëndet nga z. Dorian Matlija, drejtor ekzekutiv i Qendrës “Res Publica” si dhe znj. Vasilika Laçi, përfaqësuese e Civil Rights Defenders, Albania.

Gjatë këtij aktiviteti u diskutua lidhur me efektet e ligjit “Mbi të Drejtën e Informimit”, progresi i arritur në zbatimin e këtij ligji si dhe mangësitë e vërejtura gjatë implementimit të tij, bazuar mbi gjetjet dhe rekomandimet e një punimi kërkimor të përgatitur nga Qendra “Res Publica”, me mbështetjen e Civil Rights Defenders, sponsorizuar nga Mbretëria e Suedisë.

Debati i hapur i pjesëmarrësve pati si qëllim analizimin e efikasitetit të këtij ligji, reagimin dhe transparencën pro-aktive të institucioneve për pyetjet e ardhura nga publiku, analizimin e të dhënave nga veprimtaria e Komisionit për të Drejtën e Informimit, roli i Avokatit të Popullit etj,

me synim implementimin e modeleve më të mira për zhvillim dhe demokraci.

Të pranishmit vlerësuan raportin e përgatitur nga Qendra “Res Publica” për të studiuar efektet e këtij ligji mjaft të rëndësishme dhe theksuan se është e nevojshme që problemet që mund të jenë shfaqur pas zbatimit të tij të trajtohen me vëmendjen e duhur dhe me përfshirjen e të gjithë aktorëve dhe ekspertëve të shoqërisë.

Në mbyllje të takimit u dhanë një sërë rekomandimesh nga ekspertë dhe përfaqësues të grupeve të interesit.



Zhvillohet Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)

Tiranë, 26 dhjetor 2017



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi Mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), e cila u mbajt në ambjentet e Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD).

Mbledhjen e drejtoi znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e Kryetares së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Gjithashtu morën pjesë përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile e donatorë të huaj.



Në mbledhje u diskutua dhe u miratua Projekt - Rregullore e KKSHC-së; u votua në mënyrë unanime kandidatura e përzgjedhur nga anëtarët e shoqërisë civile në Këshill për Zëvendëskryetar të KKSHC-së; u diskutua çështja e mandateve të anëtarëve të Këshillit, përfaqësues nga shoqëria civile dhe institucioneve publike si edhe u diskutua mbi përfshirjen e Këshillit në grupet e punës në nivel ministror dhe ndërministror për çështjet publike ku duhet të përfshihet sektori i shoqërisë civile. Kjo mbledhje konstituroi Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile si organ kolegjal.

